

VENDIM
Nr. 136, datë 6.6.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 339, SERIA PV16K, DHËNË NGA BORDI I ERE-s, ME VENDIMIN NR. 51, DATË 29.4.2016, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHPELLA POSHTË 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2300 kw

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “b”, dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, pika 3, dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa “a”, dhe 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866 prot., datë 30.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës nr. 339, seria PV16K, dhënë nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 29.4.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me kapacitet të instaluar 2300 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 778 prot., datë 19.5.2022, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës nr. 339, seria PV16K, dhënë nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 29.4.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Shpella poshtë 2”, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se shoqëria ka rritur kapacitetin e instaluar të HEC-it “Shpella Poshtë 2”, nga 2300 kw në 4530 kw.

- Shoqëria “Liria Energji” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, bazuar në aneksin A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës; vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (lejet nga institucionet e tjera); ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi; të ketë kryer pagesat e aplikimit dhe të rregullimit në ERE.

Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim :

- Neni 9, pika 1, germat “a” (Të dhënat për aplikim), germa “b” (Të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (Të dhëna për aplikuesin).

- Neni 15 pika 4:

- germa “a”, një informacion me shkrim, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4:

- germa “b” (Vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës). Shoqëria duhet të depozitojë sa kërkohet nga kjo pikë e rregullores;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe të kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE konfirmimin e VNM-së paraprake; lejes së përdorimit të burimit ujqor nga organi përkatës; ose t'i përcjellë të rinovuara në

vijim të ndryshimit të kapacitetit të instaluar. Po ashtu duhet të përcjellë në ERE edhe miratimin e pikës së lidhjes me operatorin e rrjetit më kapacitetin e ndryshuar.

Shoqëria do të njoftohet që në zbatim të rregullores t'i paraqesë ato në afat.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me fuqi 2300 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti